

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE TREGETARE

"OPINGA" Shpk

Sot , me date 07.01.2020 e nenshkruara :

Znj, Aurora Kotorri shtetase Shqiptare, lindur me 05.06.1987 ne Kreshove, Permet ,banuese ne Tirane ,mbajtese e Mjetit te indentifikimit me nr 032510912,madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar .

Kam rene dakort me redaktimin e ketij akt themelimi e statute ,si me poste :

NENI 1

EMERTIMI

Themelohet nje shoqeri e se drejtes shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin " OPINGA " Shpk

NENI 2

SELIA

Shoqeria ka seline ne Tirane ne adresen : Bashkia Kamez , Bathore ,Lgj.Nr.4 ,Rr.Zadrime Godine Private Nr.87, Kati I Pare.Asamblea e ortakeve mund te themeloje filiale,seli dytesore ose njesi te tjera operative si dhe te transferoje seline e shoqerise ne nje adrese ose qytet tjetet.

NENI 3

OBJEKTI

Shoqeria ka si objekt te veprimtarese se saj :

Objekti I Shoqerise do te jete : Import-Export Mallra Industrial si dhe prodhimi dhe tregtimi me shumice dhe pakice te tyre.Prodhimi I konfeksioneve te ndryshme si dhe prodhim te veshuar kembesh me material porositesi regjimi I perpunimit aktiv Tirane-Durres material vendi per vend dhe export.



NENI 4

KOHEZGJATJA

Kohegjatja e shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar,pervec zgjatjes ose prishjes se meparshme te saj sipas Vendimit te Asamblese se Ortakeve.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar eshte I perbere nga kontributet ne te holla te ortakeve themelues ne vleren 100 000 leke (njqind mije leke).

Kapitali themeltar eshte I ndare ndermjet ortakeve si me poshte :

-Znj.Aurora Kotorri zoteron 100% te kapitalit te shoqerise qe korespondon me 1 kuote me vlere 100.000 leke

Kapitali themeltar mund te zmadhohet nepermjet kontributeve te reja ne para ose ne natyre,sipas vendimeve te asamblese se ortakeve te marra me shumicat e parashikuara per ndryshimin e ketij stauti.

Ne rast te vendimit per rritje kapitalit te shoqerise nepermjet derdhjes ne para u takon ortakeve e drejta per te nenshkruar ato ne perputhje me pjesemarrjet ne shoqeri te zoteruara prej tyre.

NENI 6

PJSEMARRJET NE KAPITALIN THEMELTAR

Pjesemarrjet e ortakeve ne kapitalin themeltar percaktohen ne raport te drejte me kontributet e tyre ne kapitalin themeltar.

Te drejtat,perfshire edhe e drejta e votes,u takojne ortakeve ne menyre perpjestimore me pjesemarrjen qe zoteron secili ne kapitalin themeltar.

Ne rast tjetersimi te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar,ortaket e tjere gezojne te drejten e parablerjes Me "tjetersim"do te kuptohet cdo akt tjersimi I kuotave ,ne kuptimin me te gjere te fjales ,si ne pronesi te plote ashtu dhe te pjesshme ,qe ,ne menyre direkte apo indirekte ,sjell ndryshimin e titullit te pronesise mbi kuotat ose te drejtat mbi to .

Ortaku qe synon te tjerersoje teresisht ose pjeserisht ,kuotat e tij ne kapitalin themeltar duhet ti komunikojte orakeve te tjere nepermjet letre rekomande ,oferten e marre,duke treguar emrin e blesesit te mundshem dhe kushtet e tjerersimit,ne menyre te vecante cmimin e percaktuar dhe menyren e pageses (ketu e me poshte referuar oferta) .

Brenda njezet diteve nga marrja e komunikimit te ofertes ,ortaket e interesuar ne ushtrimin e se drejtes se parablerjes duhet ti komunikojte ortakut qe kalon te drejtat mbi kuotat ,deshiren per te ushtruar te drejten e parablerjes,dperpjestimisht me pjesemarrjen e secilit ne kapitalin themeltar dhe sipas kushteve te ofertes ,duke shprehur edhe interesin e mundshem per blerjen e pjeses se kuotave per te cilen nuk eshte ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakeve te tjere .Eeshte I pavlefshem cdo komunikim qe nuk permban te gjitha te dhenet e mesiperme .



Ne rast se ndonje nga personat qe gezon te drejten e parablerjes se kuotave nuk mund ose nuk deshiron ta ushtroje ate, e drejta e parablerjes qe l takon zmbadhohet automatikisht dhe perpjestimisht ne favor te ortakeve qe kane shprehur interesin per ta ushtruar kete te drjete.

Ne rast se jane disa ortake qe ushtrone te drejten e parablerjes ,kuotat do te shperndahen nepermjet tyre ne perpjestim me pjesemarrjen e secilit ne kapitalin themeltar te shoqerise .Ne rast se ne letren e komunikimit te ofertes tregohet si bleres l mundshem nje person qe eshte ortak,edhe atij l njohet e drejta e parablerjes ,krahas ortakeve te tjere .

E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet per te gjithë pjesemarrjen e ofruar dhe per cmimin e percaktuar ,duke qene se l tille eshte objekti l propozimit te paraqitur nga ortaku ofrues.Ne rast se cmimi vlersohet teper l larte nga ndonjeri prej ortakeve qe ka shprehur,ne afatet dhe menytrat e mesiperme ,deshiren per te ushtruar parablerjen,cmimi l tjersimit do te percaktohet nga palet me marreveshje te perbashket ndermjet tyre.Ne rast se nuk arrihet asnje marreveshje ,cmimi do te percaktohet nepermjet raportit te ekspertit te emeruar nga palet me marreveshje ose,ne rast mosmarrveshjeje ,te caktuar nga Gjykata kompetente .Ne kryerjen e vlersimeve te tij,eksperti duhet te kete parasysh situaten pasurore te shoqerise,te rentabilitetit te saj,te vleres se pasurive material dhe jomateriale qe ajo posedon,te pozicionit te saj ne treg si dhe te cmimit dhe kushteve te ofruara nga bleresi potencial,nese ky eshte me mirebesim,si dhe cdo rrethane apo kusht tjeter qe merret normalisht ne konsiderate per caktimin e vleres se pjesemarrjeve ne kapitalin themeltar te shoqerise .

Ne rastin e ushtrimit te se drejtes se parablerjes,nenshkrimi l kontrates se shitjes se kuotave dhe pagesa perkatese duhet te kryhet Brenda afateve te percaktuara ne propozimin e shitjes se formuluar nga ortaku ofrues.

Nese e drejta e parablerjes nuk ushtrohet Brenda afateve te mesiperme dhe per teresine e pjesemarrjes se ofruar ,ortaku ofrues mund ti transferoj kuotat e veta ne favor te bleresit te treguar ne komunikimin e ofertes dhe ne kushtet e parashikuara ne te Brenda gjashtedhete diteve te ardhshme.

Ne te kundert ,procedura e parablerjes duhet te perseritet .

Ne rast tjeresimi te kuotat ne favor te te treteve ,pa zbatuar dispozitat e parashikuara me siper,bleresi nuk do te legjitimohet ne ushtrimin e te drejtave administrative dhe pasurore dhe tjetersimi l kuotave nga ana e tij nuk do te prodhoje efekte ndaj shoqerise.

Nese asnjeri prej ortakeve nuk e ushtron te drejten e parablerjes ne menytrat e percaktuara ,ortaku ofrues mund te nenshkruaje aktin e shitjes se pjeses se tij ne perputhje me dispozittat ligjore ne fuqi.

E drejta e parablerjes nuk eshte domosdoshmerisht e nevojshme te ushtrohet prej ortakeve,ne rast transferimi tek familjaret ,te kuotave ose pjese te kuotave te zoteruara prej tyre .

NENI 7

DOREHEQJA



E drejta per tu dorehequr I takon ortakeve qe nuk kane miratuar vendimet ne lidhje me :

-Ndryshimin e objektit te veprimtarise apo te formes se shoqerise ,

-Perthithjen apo sherberjen e shoqerise,

-Transferimin e selise se shoqerise jashte vendit,

-Revokimi I gjendjes se likuidimit,

-Eliminimi I nje ose disa shkaqeve te doreheqje te parashikuar ne Statur,

-Futja apo ndryshimi I kufizimeve per transferimin e kuotave,

-Ndermarrja e veprimeve qe sjellin nje ndryshim thelbesor te objektit te veprimtrise se shoqerise ose nje ndryshim lidhur me te drejtat qe u jane njohur ortakeve,

-Zmadhimi I kapitalit te shoqerise I bere nepermjet ofertimit te kuotave dhe emerimi I tyre nga te trete ,

-Ne te gjitha rastet e tjera te parashikuara nga lidhi ose nga ky Statut.

Synimi I ortakut per te ushtruar te drejten e heqjes dore ,ne rastet e siperpermendura duhet ti komunikohet Organit Administrativ nepermjet letres rekomande Brenda tridhjete diteve te regjistimit ne librin e vendimeve te ortakeve te vendimit qe e legjitimon,ose tridhjete dite nga marrja dijani nga ana e ortakut.

Heqja dore do te konsiderohet e ushtruar ne ditet qe komunikimi ka mberritur ne seline zyrtare te shoqerise.

Heqja dore nuk mund te ushtrohet,dhe ne rast se eshte ushtruar nuk do te jete e vlefshme,nese Shoqeria Brenda nentehjete diteve nga ushtrimi I doreheqjes revokon vendimin qe ka legjitimuar doreheqjen.

Ortaket qe largohen nga shoqeria kane te drejten e marrjes se rimbursimit te zoterimeve te tyre ne proporcion me pasurine e shoqerise.

Pasuria e shoqerise percaktohet nga Organi Administrativ,pasi ka degjuar mendimin e reviziorve dhe mbkqyresve ,nese k ate emeruar,duke mbajtur parasysh vleren e tregut te shoqerise ne momentin qe heqja dore ka hyre ne fuqi.

Ne rast mordakordesie,vlersimi I zoterimeve ,sipas kritereve te siperpermendura,behet nepermjet raportit ten je eksperti te betuar te emeruar nga Gjykata Kompetente.

Rimbursimi I zoterimeve duhet bere Brenda njeqind e tetedhjete diteve nga momenti I miratimit te likuidimit.

Rimbursimi mund te behet nepermjet blerjes nga ana e ortakeve te tjere proporcionalisht me kuotat e zoteruara prej tyre,ose nga nji I trete te rene dakort nga ortaket e shoqerise.

Nese nuk arrihet si me siper,rimbursimi behet duke perdorur rezervat e disponueshme ose ne mungese duek reduktuar kapitalin e shoqerise ne proporcion me kuoten qe likuidohet.



NENI 8

VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e ortakëve vendos mbi ceshtjet që i rezervohen nga ligji ose nga ky Statut, si dhe mbi ceshtjet që njeri ose disa prej administratorëve i paraqesin për miratimin. Ortaket gezojnë të drejtën të therrasin asamblet e ortakëve në rastet dhe me shikimet e parashikuara me ligj. Janë në çdo rast kompetencën e Asamblese së ortakëve, që vendos me votën e ortakëve sipas kuorumit të kërkuar nga ligji, për vendimet që kanë lidhje me :

- miratimin e bilancit dhe shpërndarjen e fitimeve,
- emerimin, shkarkimin e administratorëve dhe përcaktimin e strukturës së organit administrativ,
- ndryshimet e kësaj statute,
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar,
- ndryshimin e formës së shoqërisë ose ristrukturimin e saj,
- vendimet në lidhje me shpërndarjen e parakohshme të shoqërisë,
- marrja dhe transferimi i pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera,
- emerimi, shkarkimi dhe zëvendësimi i ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve duke përcaktuar në këtë rast kriteret e likuidimit,
- blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme
- përcaktimi i shpërblimeve të administratorëve,

Vendimet e ortakëve mund të merren :

- në formën e mbledhjeve të asamblese
- nëpërmjet konsultimit me shkrim
- në bazë të konsensusit të shprehur me shkrim



NENI 9

THIRRJA E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleaa e ortakeve e thirrur rregullisht perfaqson bashkesine e ortakeve dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me lidhin dhe kete statut jan te detyrueshme per te gjithë ortaket ,edhe nese keta mungojne ose nuk jane te te njejtë mendim .Asamblea e ortakeve thirret me njoftim derguar ortakeve ne vendbanimin e tyre ose ne adresen e postes se tyre elektronike dhe l marre prej ketyre te pakten 7 (shtate) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e asamblese . Ne njoftimin e thirrjes duhet te tregohet vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista e ceshtjeve ne rend te dites . Ne rast mosrespektimi te formaliteteve te mesiperme, asamlea do te konsiderohet e thirrur rregullisht vetem nese eshte perfaqsuar teresia e kapitalit themeltar dhe asnji nuk kundershton diskutimin e ceshtjeve ne rend te dites.Asamblea drejtohet nga administrator .Drejtuesi l asamblese konstaton mbledhjen e rregullt te saj, verifikon identitetin dhe legjitlmin e te pranishmeve,drejton dhe garanton zhvillimin e rregullt te asamblese si dhe verifikon dhe shpall rezultatet e votimeve.

Mbledhjet e Asamblese se ortakeve mund te mbahen dhe nerpermjet video konferences ose tele konferences ,me kusht qe te gjithë pjesemarrësit te mund te identifikohen dhe te dallohen ne cdo monet te lidhjes,dhe tu lejohet te ndjekin diskutimin,te marrin,dergojne dhe vezhgojne dokumentat ,te nderhyjne gojarisht dhe ne kohe reale mbi te gjitha ceshtjet ,si dhe te marrin pjese ne votim dhe te vendosin,ne menyre te tille qe tem und te garantohej metoda kolegjinale dhe zbatimi l parimeve te mirebesimit dhe barazise se trajtimit te ortakeve.Ne prani te kushteve te mesiperme,asamblea e ortakeve konsiderohet e mbajtur ne vendin ne te cilen gjendet drejtuese l saj.Cdo ortak k ate drejten e pjesemarrjes dhe te votes ne asamble ne perpjestim me pjesemarrjen qe zoteron kapitalin themeltar.

Ortakët mund te perfaqsohen ne asamble nga persona te tjere nepermjet procure te posacme.Prokura eshte e vlefshme vetem per asamblene per te cilen leshohet ,te identifikuar sipas rendit te dites.Ortakët nuk te perfaqsohen nga administrator l shoqerise..Vota duhet te jete e hapur ose gjithsesi te shprehet me modalitete te tilla qe bejne te mundur identifikimin e ortakeve qe nuk jane te te njetit mendim.Modalitetet e votit miratohen nga asamblea e ortakeve me shumicen e te pranishmeve,mbi propozim te administratorit.Ne rast se nuk parashikohet ndryshe me ligj,pjesët e kapitalit themeltar per te cilat nuk mund te ushtrohet e drejta e votes do te llogariten per efekt te kuorimit te nevojshem per mbledhjen e vlefshme te asamblese .Vendimet e asamblese se ortakeve duhet te pasqyrohen ne procesverbalin e mbledhjes,te nenshkruat nga drejtuesi.Procesverbalit te asamblese l bashkangjitet lista e pjesemarrësve dhe njoftimet e thirrjes.

NENI 10

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te admnistrohet nga nje administrator l vetem,l cili qendron ne detyre per 5 vjet dhe mund te rizgjidhet .Asambleja e ortakeve mund te vendose shkarkimin e administratorit me shumice te zakonshme.



Administrator I shoqrise emerohet Znj.Aurora Kotorri ,per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje .

NENI 11

KOMPENTENCAT E ADMINISTATOREVE

Administratori ka te gjitha kompetencat per administrimin e zakonshem dhe te jashtzakonshem te shoqerise ,me perjashtim te vendimeve qe ligji,akti themelimit dhe statute I rezervojne asamblese se ortakeve.Administratori gezon te drejta dhe fuqi te plota per kryerjen e cdo veprimi dhe ose operazoni qe vlerson te dobishem per realizimin e objektit te shoqerise.Perpos asaj cka parashikohet nga lidhi administrator ka detyren e kryerjes se veprimeve te meposhtme:

-hartimin e inventarit te llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin,ne mbyllje te cdo viti financiar

-hartimin e projekteve te bashkimit ose ndarjes se shoqerise

-te infrmoje asamblene mbi zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e operacioneve tregtare me rendesi per shoqerine

-te raportoje perpara asamblese se ortakeve mbi faktet qe mund te kene pasoja negative mbi ecurine apo ekzistencen e shoqerise

-te therrase asamblene e ortakeve ne rastet e parashikuara me ligj

Administatoret mund te delegojne perfaqesues te posacem per kryerjen e akteve te vecanta ose te nje kategorie aktesh ,duke percaktuar kompetencat perkatese.

NENI 12

PERFAQESIMI

Administratori ka te drejten e perfaqesimit te shoqerise kundrejt te tretave dhe ne gjykim.Ai mund te caktoj avokate dhe perfaqesueses te shoqerise perpara organeve gjyqsore,organeve te administrates shtreterore dhe te treteve,si dhe perfaqesueses te posacem per akte te vecante ose kategori aktesh.Edrejta e firmes se shoqerise mund te ushtrohet dhe nga personat te cileve u eshte deleguar kjo e drejte Brenda kufijve te kompetencave te dhena.Administratori ka te drejten e rimbursimit te shpenzimeve te bera gjate ushtrimit te funksioneve si dhe nje shperblim vjetor te percaktuar nga asamblea e ortakeve ne momentin e merimit ose me vendim te posacem.



NENI 13

VITI USHTRIMOR DHE BILANCI

Viti ushtrimor mbyllet ne 31 Dhjeotr te cdo viti.

Ne mbyllje te cdo viti ushtrimor,organi administrative harton bilancin e vitit ushtrimor ,Brenda afateve dhe ne perputhje me dispozitat e ligjit.Bilanci mund tu paraqitet ortakeve per miratim Brenda njeqindetetedhjetete diteve nga mbyllja e vitit ushtrimor.Dokumentet e kontabilitetit ,te shoqeruara nese e nevojshme nga relacioni I eksperteve kontabel te autorizuar ,duhet tu komunikohen ortakeve dhe te vihen ne dispozicion te tyre prane selise se shoqerise,te pakten 15 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese.

NENI 14

FITIMET

Fitimet qe realizoje nga bilanci ushtrimor do te shperndahen ndermjet ortakeve pasi te jene zbritur nga kjo shume vlera e humbjeve te pasuara gjate vitit ushtrimor paraardhes si dhe 5% (pese per qind) qe destinohet per fondet e rezerves se domosdoshme,derisa kjo te kete arritur kufirin e parashikuar me ligj.

Pjesa qe mbetet pas zbritjes se zerave te mesiperm,do tu shperndahet pronarve te kuotave te kapitalit themeltar perpjestimisht me pjesmarrjet e tyre,ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi,me perjashtim te destinimit te ndryshem te vendosur nga vete ortaket.

NENI 15

FINANCIMI I ORTAKEVE

Shoqeria mund te marre nga ortaket financime me ose pa shperblim,ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.Dhenia e ketyre financimeve nga ana e ortakeve eshte e lire .

NENI 16

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Shperndarja e parakohshme e shoqerise vendoset nga asamblea e ortakeve me shumicat e parashikuara per ndryshimin e ketij statute,ne rastet e parashikuara nga ligji.

Ne rast se realizohet ndonjeri nga shkaqet qe sjell shperndarjen e shoqerise ,asamblea e ortakeve,me vendim te posacem te marre gjithmone me shumicat e parashikuara per ndryshimin e statutit ,do te percaktoje modalitetet e likuidimit dhe do te emeruje nje ose disa likuidatore duke percaktuar njekohesisht edhe kompetencat perkatese.Shoqeria mund te anulloje ne cdo moment gjendjen e likuidimit ,me vendim te asamblese te marre me shumicat e parashikuara per ndryshimin e ketij statuti.



NENI 17

ZGJEDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarreveshjet qe mund te linden ndermjet ortakeve ose ndermejet ortakeve dhe shoqerise dhe qe ka lidhje me te drejta te disponueshme ne lidhje me marredheniet e tyre me shoqerine do ti drejtohen per zgjidhje Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane .

NENI 18

LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM

Gjithcka nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut do ti disiplinohet nga dispozitat ligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 19

DISPOZITA FINALE

Ky akt redaktohet ne 1 kopje ne gjuhen Shqipe , Lexuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaket themelues .

ORTAKET THEMELUES

AURORA KOTORRI

Aurora Kotorri

